



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 200, datë 11.06.2020

PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË PËRKOHSHËM PËR SHQYRTIMIN E ANKIMEVE KUNDËR VENDIMEVE TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË PËR ARKIVIMIN E ANKIMIT OSE PUSHIMIN E HETIMIT NDAJ NJË GJYQTARI”

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 147, pika 1 dhe 147/a, pika 1, shkronja “ë”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 70, pika 2, 97, pika 1, shkronja “ç” dhe 98, pika 3, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, pasi shqyrtoi projekt-rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përkohshëm për Shqyrtimin e Ankimeve Kundër Vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për Arkivimin e Ankimit ose Pushimin e Hetimit ndaj një Gjyqtari” e propozuar nga Komisioni i Përkohshëm i krijuar me Vendimin e tij nr. 171, datë 28.05.2020,

VENDOSI:

1. Miratimin e Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përkohshëm për Shqyrtimin e Ankimeve Kundër Vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për Arkivimin e Ankimit ose Pushimin e Hetimit ndaj një Gjyqtari”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR